



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 6.05.2016, merr këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**

**FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

I. Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Prishtinës.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit, kryesues,
2. Ylli Hoxha (LVV), anëtar,
3. Lirie Avdiu (PDK), anëtare,
4. Rita Begolli (AAK), anëtare,
5. Remzi Pacolli (AKR), anëtar,
6. Kimet Zeqa (PD), anëtare,
7. Abetare Fazliu (LB), anëtare,
8. Cuneyd Ustaibo (KDTP), anëtar,
9. Visar Arifaj (PF), anëtar,
10. Nenad Miladinoviq (G.I.S), anëtar,
11. Ardian Olluri, Udhëheqës i Zyrës ligjore, anëtar,
12. Zijadin Gashi, shef i Sektorit për punë të Kuvendit, anëtar,
13. Albulena Ndrecaj, Shoqëria civile, anëtare.

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës, me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të Komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të plotësojë dhe hartojë Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Prishtinës. Pas plotësimit dhe hartimit të Rregullores, grupi punues do ta prezantojë atë para Kuvendit të Komunës për miratim.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 038-112179, më 11.05.2016**



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**